



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës

Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

FTOJ

Mbledhjen e dytë e rregullt e Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: **27.02.2020** (e enjte) duke filluar në ora **10:00**.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-se;
2. Aprovimi i Raportit Financiar tremujor për periudhen kohore Tetor - Dhjetor 2019;
3. Raport nga DSHP rreth realizimit të rrugës dhe ujësjellësit në fshatin Stanishor;
4. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 18.02.2020
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 30.01.2020, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Predrag Stojkovic, Ivica Cenic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Selatin Nuhju, Dobrivoje Djordjevic, Xhejlane Behluli, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, ZBPZHR Avdi Vllasaliu, përfaqësuesi i OSBE-së dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 12 antarë të Kuvendit nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raporti i Kryesuesit për punën e Kuvendit për vitin kalendarik 2019;
3. Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2020;
4. Dhënja e pelqimit për ndrimin e Destinacionit nga Toka bujqësore në atë Ndertimore;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Aprovohet rendi i ditës nga antarët prezent të Kuvendit me 10 vota për dhe 2 kunder (Predrag Stojkovic, Negovan Jovanovic).

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali nga antarët prezent të Kuvendit me 10 vota dhe 2 kunder (Predrag Stojkovic, Negovan Jovanovic).

Pika e dytë: Raporti i Kryesuesit për punën e Kuvendit për vitin kalendarik 2019;

Kryesuesi tha: e keni marrë raportin me material, ju të gjithë e dini se ne çdo muaj kemi mbajtur mbledhje të Kuvendit, mbledhje të rregullta si dhe të KPF-së, kemi mbajtur një mbledhje urgjente. Kuvendi ka aprovuar gjithësej për një vit 17 vendime dhe të gjitha janë të verifikuara nga ana e Ministrisë Kompetente. Raportin e keni marrë me kohë kështu që spo e zgjas më tepër nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Predrag Stojkovic pasi përshendeti të pranishmit tha: dashta ta marr fjalën me rastin e votimit të rendit të ditës por po e marr tash. Zt.Kryesues ju e dhatë një raport ku janë pruar siç e ceket 17 vendime unë jam antarë i këtij Kuvendi për 6 vite dhe mendoj se ky është numri më i vogël i vendimemev pothuajse prej kur punon ky Kuvend. Nuk e di se a e keni pregaditur ju raportin apo dikush tjetër, nese ju e keni pregaditur këtë raport ju them se ka shumë gabime gramatikore që më të vertet nuk është në rregull,

mendoj se ky është një perkthim dhe është bërë keq. Në bazë të Ligjit për Vetqeverisje Lokale 9.1 dhe statutit të Komunës së Novobërdës thuhet se dy gjuhë janë në përdorim, gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Qytetarët i kanë paraqitur disa kërkesa por nuk po e di se për çfarë bëhet fjalë këtu pasi që këto kërkesa janë vetëm në gjuhën shqipe dhe nuk di se si të kontriboj në këto kërkesa që deshirojnë qytetarët të realizojnë, disa herë kam thënë se unë më tutje nuk deshiroj të marr pjesë në punën e Kuvendit pasi që nuk ka mundësi që unë të marr pjesë aktive andaj do ta lëshoj mbledhjen e sotit e besoj se në të ardhmen do ta marr materialin në bazë të ligjit, ju faleminderit.

Mbledhjen e lëshuan antarët: Predrag Stojkovic dhe Negovan Jovanovic.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: mendoj se Predragi foli pothuajse mirë por një gjë po harron se me të vërtetë në raport kemi dhe nuk është faji i Kuvendit por i egzekutivit. Çdo Komunë Egzekutivi i bënë presion Kuvendit me shqyrtu më shumë pika, ndërsa qëllim i egzekutivit të Komunës së Novobërdës qëllim i tij është me të vetëm megjull e mos me kry asnjë punë nuk e di se deri kur do të shkoj kështu. Çdo kunë ka demkroaci ka kundërshtime por ai që është obligativ të bij pika në Kuvend, të bij rregullore, ndërsa te ne po fillon viti i tretë dhe ende nuk është aprovuar rregullorja e tatimit në pronë kjo është shkelje flagrante, e dini se Komuna jonë është e vetmja që nuk e ka emrimin e rrugëve dhe kush është fajtori?, Kuvendi i ka formuar komisionet. Ne seancën e kaluar e dini mirë se skemi pasur rrym është ka perkthyer përkthyesi këtu në sallë. Kryesues ju e keni kryer punën tuaj e keni sjell një raport dhe normal më shumë ske pas mundësi me shenu pasi që ky është realiteti dhe nuk e di që kemi pas mundësi me aprovu diçka më shumë e nuk e kemi aprovu aq sa kemi pasu mundësi kemi punuar, ju faleminderit.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: Kryesues nuk e di se si ke pasur sot guzim që të raportosh kur dihet se çka ke bërë që 1 vit këtu në Kuvend. Pika e parë asnjëherë nuk ke qenë në mbledhje të komitetit për komunitete, në asnjë seminar nuk ke marrë pjesë, asnjëherë nuk të kam parë këtu në Komunë, e kemi pas me shku në Shqipëri e kemi votuar këtu në Kuvend por nuk kemi shkuar, buxhetin e Kuvendit nuk po e shfrytëzojnë as 5% ku po shkon aj buxhet kush po e shfrytëzon. Asnjë vendim nuk është aprovuar në Kuvend që Kryetari ka propozu mu votu, Kryetari ka të drejt me shpernda Kuvendin kur Kuvendi nuk funksionon mirë, nuk shkon më kështu, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: në bazë të cilit ligj Kryetari ka të drejt me shperbë Kuvendin?

Zymer Zymeri tha: mos e aprovo buxhetin tana shohim, po ju çka po bënë po e aprovon buxhetin e propozuar nga Kryetari e po e dergoni tjera projekte.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: është keq mu mundu me ja hudh fajin Kuvendit Komunal dhe është një taktike e keqe kur pozita e liron sallen dhe e bojkoton, kjo tregon përgjegjësin ndaj qytetarëve. Të gjithë e dim se Predragi ka qenë një keqperdorues ku ka shfrytëzuar edhe makinën zyrtare edhe pas kalimit të mandatit si Kryesues i Kuvendit. Unë ndi keqardhje se si LDK-ja po bëhet vartës i kësaj keq qeverisjes e nuk po mushet mend që me u largu prej kësaj qeverisje e me u bashku me qytetarët që janë kanë dhënë votën që me i mbrojt interesat. Derisa Kuvendi nuk ka bashkpunim e qeverisjen atëherë ne si Kuvend e krym punën tonë por perderisa egzekutivi nuk bjen material dhe e neglizhon punën tonë është e pandershme dhe shkelje flagrante që po e bëne qeverisja aktuale, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: nese nuk ka diskutime tjera kalojna në piken tjetër.

Pika e tretë: Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2020;

Kryesuesi tha: e keni marrë me material propozim orarin për mbajtje të mbledhjeve të Kuvendit për këtë vit kalendarik, kemi pasur kujdes që mbledhjet mos të mbahen të premtave si dhe në ditë feste, a keni ndonjë propozim ose datë që nuk ju përshtatet?

Pasi nuk pati propozime aprovohet plani i punës së Kuvendit për vitin 2020 me 10 vota për nga të gjithë anëtarët prezent të Kuvendit dhe mirrën ky:

VENDIM

APROVOHET Plan i punës së Kuvendit për vitin 2020 të Komunës së Novobërdës.

Pika e katërt: Dhënja e pelqimit për ndrimin e Destinacionit nga Toka bujqësore në atë Ndertimore; Kryesuesi tha: i kemi disa kërkesa nga Drejtoria e Bujqësisë për ndrim të kultures së tokës për të na informuar më shumë ja dha fjalën ZBPZHR Avdi Vllasaliut.

Avdi Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: i kemi tri kërkesa nga tre qytetarë për destinacionin e tokave nga toka bujqësore në tokë ndertimore. Kërkesa e parë është e Gani Aliut e ka tokë pyjore dhe nuk është kontrolluar më heret dhe kjo kërkesë tëhiqet pasi që për atë parcel duhet të mirret pelqimi ne Ministri të Bujqësisë. Sa i përket kërkesës së dytë të Qendrim Mehmetit ngastra kadastrale është në Parallov ka bërë kërkesë për ndrimin e parces së klases së 6, për klasen e 6 në bazë të nenit 9 dhe 10 shkon permes Kuvendit dhe miratohet nese miratohet e ipet pelqimi nga Drejtoria e Kadastrit. Kërkesa e tretë është e Zymer Miftarit nga Koretishta e ka pelqimin nga Ministria e Bujqësisë për destinim të tokës e tash duhet të mirret vendimi edhe nga Kuvendit. Nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: nuk është se po e perkrahi Predragin por më të vërtet është shqetësuese pasi që po e sheh se kërkesat janë shqip mirëpo ai nuk e ka në gjuhen e vet perderisa ne jemi Komunë multietnike, andaj si sugjerim që çdo kërkesë të jetë në të dy gjuhët, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti tha: po shihet se në kërkesa ka jo profesionalizem, me rregullore dhe udhëzim administrativ së pari ish se duhet të ipet pelqimi prej Ministrisë së Bujqësisë e pastaj nga Kuvendi rasti i Qendrim Mehmetit, kjo është fatkeqësia më e madhe pas që leje ndertimi ka marrë për me ndertu objektin në muajin e 6 dhe si ka mundur ta marr lejen e objektit kur se ka bërë regjistrimin e pronës, kjo është një shkelje e papranueshme, i njeiti rast është të pompa ajo funksion që 2 vite ndërsa tash kërkohet pelqim. Me vet faktin se u ardh zyrtari e nuk ka ardh Drejtori i Bujqësisë që ta prezantoj këtë pikë këto pikë nuk janë që të perkrahen, Drejtori është obligativ që ti mbroj këto pika dhe në fund kush po pson po pson qytetari, ju faleminderit.

Xhejlane Behluli tha: këto kërkesa janë diskutu edhe në KPF se pse nuk kanë ardh më herët me material e din edhe Kryesuesi dhe ne e perkrahem për Kuvend e këtu të diskutojm ndërsa a është në gjendje mi mbrojt të gjitha këto pyetje që i kemi mbetet të zyrtari.

Ramush Mehmeti tha: kërkesa e Zymer Miftarit është bërë me 23 janar atë ditë është mbajt KPF-ja.

Avdi Vllasaliu tha: ne atë ditë e diskutum se disa kërkesa na kanë ardh e vones dhe pasi që KPF-ja ishte atë dit i kem propozu për rend dite që të vin në Kuvend. Sa i përket kërkesës së Qendrim Mehmetit e ka fitu projektin nga Ministria e Bujqësisë për ferm të pulave, objektin eka ndertu lejen e ka marr prej Ministrisë ndërsa tash ja ka kërku Ministria ndrimin e destinacionit prej tokes ndertimore në tok bujqësore që mos ti humbet projekti pasi që ai ka hy kredi për me ndertu objektin.

Dobrivoje Dordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: e perkrahi zt. Stojkovic që tha për perkthim të materialeve pasi që duhet të jenë në të dy gjuhët, por sa i përket ndrrimit të destinacionet të këtyre tokave se kemi marr arsyetimin se çka do të përfitoj Komuna?, sa do të jenë të hyrat?, sa do të paguaj tatim?, sa puntorë do ti marrin në punë?, mos të del se është interes personal i dikujt, ju faleminderit.

Avdi Vllasaliu tha: sa i përket pagesës së ndrrimit të destinimit të tokës prej klasës 1-4 metri katror është 1€ ato mjete shkojnë në buxhet të Komunës në Drejtori të Bujqësisë, prej klases 5-6 është 0.75€ për m² dhe prej klases së 7-8 është 0.50€ për m², sa i përket punëtorëve sa merr nuk e di pasi që ai po kërkon vetem destinimin e parces.

Jahi Zeqiri pasi pershendeti të pranishmit tha: vetem një pyetje për zyratirn për Qendrim Mehmetin që ka bërë kërkesë për destinim të pronës për arsye se ka për qëllim me fitu një grand, çka ndodhë nese nuk i ipet pelqimi a do ti rrënohet ai objekt që është ndertu para kohës?, andaj kisha kërku nga të gjithë asamblesitat për mirëkuptim pasi që veq një pikë u terhjek për gabime të tyre të tërhiqen të tri pikat nga Kuvendi i sotëm, nese na vin me përmirësime dhe është dikush që i mbron kërkesat e qytetarëve atëher sdo të jemi kunder kërkesave të qytetarëve pamvarsishtë a është qytetarë i joni apo jo, por nese një tërhiqet dhe një perkrahet atëher nuk jemi të drejt, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: besoj se kjo është neglizhenc e Drejtorisë përkatëse e cila i ka dhënë leje ndertimore pa e destinuar pronën prej asaj bujqësore në atë ndertimore, duke pas parasysh se fajtori është këtu në Komunë është person zyrtarë mendoj se pasojat i paguan qytetari i cili ka investuar duke e ditur se Komuna jonë është në një varfëri ekstreme dhe kemi shumë pak biznese brenda Komunes tonë, unë nuk jam për ta penguar këtë investim, unë jam për me kalu për arsye se gjatë gjithë kohës thirrmi me një si një Komunë e varfër dhe me numër të papunëve dhe ne mi nderpere dy biznese unë nuk marrë pergjegjësi që me i ndalu së operuari këto biznese.

Avdi Vllasaliu tha: po ju lexoj nenin 13 pyjet dhe tokat pyjore dispozitat e këtij udhëzimi administrativ aplikohen me perdorimin distininimin e këtyre tokave pyjore. Neni 13.2 ndrrimi, destinim i pyjeve apo tokave pyjore përveq kushteve dhe procedurave me këtë udhëzim administrativ përveq klasave dhe tokave duhet të mirrët pelqimi nga Ministria. Dmth ne nuk kemi të drejt as Kuvendi ne me dhënë pelqimin për tok pyjore pa e dhënë pelqimin Ministria e Bujqësisë në bashkpunim me agjensionin pyjor. Unë nuk po e terhej po e terhej ligji jo pse po du unë, por në fillim nuk është shiku kultura e tokës pasi që në bazë të udhëzimit administrativ për tok pyjore mirret pelqim në Ministri dhe agjension të pyjeve. Xhejlane Behluli tha: mendoj se perderisa vet zyrtari po e terhej këtë kërkes ka gabime por kerkesat tjera mendoj se duhet me i përkrah.

Zymer Zymeri tha: në këto gjëra shumë duhet me pas kujdes, e përkrahi Jahirin që tha se duhet të tërhiqen këto pikë, këtu duhet të garantoj Drejtori i Bujqësisë se është në rregull, se në krejt tokat kanë bërë dallavere, duhet ditur kur dikujt i jep leje se për çka po ipet, te Tullarët u ardh prej Serbis e ka ble tokë të shtetit çka do të bëjnë tash fshatrat ku do ti kullosin bagetit?.

Avdi Vllasaliu tha: këtu jemi tu bisedu për prona private e jo prona shoqërore, këtu ka bërë kërkes për ndrrim të kultures së pronës në mënyrë që ti marr mjetet e projektit pasi që objektin e ka ndertuar.

Jahi Zeqiri tha: unë një gjë nuk po e kam të qartë, objektin e kam ndertu është pajis me leje e realisht destinimin se ka pas e kjo është dasht të ndodh para ndertimit, faji është te qytetari vet, nuk jam kunder qytetarëve, jam pro qytetarëve po është dasht mi kqyr më herët këto e jo në momentin e fundit, kështu që kerkoj mi terhej të tri pikat nga rendi i ditës.

Ramush Mehmeti tha: Qendrim Mehmeti se ka marrë pelqimin nga Ministria ndërsa udhëzimi aministrativ thotë se së pari duhet të mirret pelqimi në Ministri për arsye se zyrtarër komunal nuk e kan informuar si duhet, është duhur ta njoftojn se pelqimi duhet të mirret së pari në Ministri, këtu është shkelje ligjore andaj kerkoj që kto pika të shyhen të mirret pelqimi në Ministri e në mbledhjen e ardhshme e marim vendimin në Kuvend.

Xhejlane Behluli tha: a kemi kohë ti shtym dëni në mbledhjen e ardhshme a dëmtohen qytetarët?.

Avdi Vllasaliu tha: me 5 shkurt e ka mi dorzu dokumentat.

Jahi Zeqiri tha: ka pas mundësi me angazhu një ekspert për këtë punë dhe me ja rregullu dokumentat kështu që kerkojm falje por është mirë mu vedijsu edhe për herave tjera.

Kryesuesi tha: pasi që vetem njëra kërkes e ka pelqimin propozoj që kjo pikë të shtyhet për një nga mbledhjet e ardhshme të Kuvendit pasi që kemi pasur ankesa edhe për mosperdorim të dy gjuhësisë.

Me 6 vota për, 2 kunder (Xhejlane Behluli, Zymer Zymeri) dhe 2 të përmbajtur kjo pikë shtyhet për një nga mbledhjet e ardhshme të Kuvendit.

Pika e pestë: Të ndryshme;

Kryesusi tha: te kjo pikë propozoj marrjen e vendimit për mbushje telefonike ashu siç kemi vepruar për çdo vit që kemi marrë mbushje ne si kuvend si dhe zyrtarët dhe asistentja e Kuvendit.

Kryesusi e hapi diskutimin rreth këtij propozimi.

Aprovohet njëzëri nga antarët prezent të Kuvendit ky propozim dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET vendimi për mbushje telefonike.

Ramush Mehmeti tha: po e ngris një shqetësim shumë të madhë, Kuvendi Komunal e ka aprovuar buxhetin në vitin 2019 ka hartuar listen e projekteve dhe kërkoj ta di a janë realizu edhe pse ka qenë detyr e Kryetarit të Komunës që dy herë të raportoj gjatë viti për punën e vet por një gjë të till nuk është duke e bërë. Lista e projekteve nuk është realizu ashtu siç është votuar pasi që po e perdor buxhetin si personal. Kryetari e ka obligativ që çdo vendim të Kuvendit ta realizoj, kanë mbet shumë projekte që kanë qenë në list të projekteve por nuk janë realizuar si në fshatin Llabjan kanalizimi, në fshatin Koznic ndriqimi, në fshatin Tullarë kanalizimi, në fshatin Stanishor asfaltimi i rrugës. Mos ta akuzojm Kuvendin por me vet faktin se Kryetari nuk merr pjesë në seanc të Kuvendit po tregon se është i dyshimt për çdo gjë.

Dobriroje Djordjevic tha: në mbledhjen e komiteti për komunitet kam propozuar dy pika për Kuvend por nuk e di pse nuk kanë ardhur këtu, e para është për ujësjellë në fshatin Stanishor dhe tjetra është ndertimi dhe sanimi i rrugës së fshatit Stanishor. Kryetari ka premtuar ujësjellësin, qështja tjetër është se rruga është e shkatërruar dhe nuk po e di se pse këto pika nuk kanë ardh në Kuvend e din asistensa se këto pika janë votuar që të vin këtu edhe përfaqësuesi i OSBES na ka njoftur se pikat mundë të vin direkt në Kuvend pa kaluar në KPF prej Komitetit.

Kryesusi tha: çka konkretisht rruga në Stanishor?.

Dobriroje Djordjevic tha: sanim, rregullim i rrugës.

Kryesuesi tha: e kemi pasur një takim dhe Komuna ka dhënë pajtueshmeri që të vendosin shenja kufizues por me pastaj kanë thënë se ajo është rrugë regjionale.

Dobriroje Djordjevic tha: çdo herë do të kërkoj që të vendosen shenja në atë rrugë, pasi që shumë është e demtuar.

Xhejlane Behluli tha: koleg këtu jemi për qytetarët i kemi pasur debatet publike dhe asnjë nuk keni marrë pjesë, krejt këto që po i kërkon sot është duhur ti kerkoni në degjim publik, unë personalisht dy pika i kam shtuar në rend dite në KPF-ë me kërkesa të protokuluara të qytetarëve të fshatit Stanishor, dmth nuk po kerkoni diçka kur po është momenti. Po nderlidhem me një qështje të kjo pikë, para tri viteve është diskutu në këtë Kuvend prej përfaqësuesit të kshillit të fshatit por në të njëjten kohë kan marrë pjesë edhe qytetarët e fshatit Pasjak, ka të bëjë me fatkeqësit natyrore që ka ndodhë ku disa qytetarë kan pësuar dëme në shtëpit e tyre, qytetari është mundu ka ardh deri këtu, unë ju kisha lut si Kuvend pasi që ju është premtuar edhe më heret ta marrim një vendim që ti zvoglohet tatimi në pronë, ose të shohim pasi që komsioni ka dal dhe e ka verifiku se sa janë ato dëme, ka qen qytetari edhe të zyrtarët e tatimit në pronë dhe ata i kanë thënë se i vetmi organ që mundet ta ndryshoj është Kuvendi, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti tha: fatkeqësi është se ne ende se kemi aprovuar rregulloren e tatimit në pronë, edhe pse është obligative, pasi qe çdo fund vit kur të aprovohet buxheti obligativ është që të aprovohet edhe rregullorja e tatimit në pronë, kur të aprovohet rregullorja aty duhet të ceken pasi që edhe më herët e kemi marrë një vendim që veteranet të lirohen nga pagesa e tatimit në pronë, pra ato vendime me rregullore rregullohen. Problemi është se këta jaën duke punuar kunderligjshëm që dy vite obligative në fund të tetorit është duhur të aprovohet rregullorja e tatimit në pronë, është duhur të bëhen ndryshimet e zonave të del në degjim publik por këta janë duke punuar paushall.

Xhejlane Behluli tha: të gjithë ne jemi taksapagues të tatimit, në bazë të një rregullore jemi tu pagu, ne mundemi me ja mundësu me ju zvoglu tatimi në pronë, sa i përket aprovimit të rregullores personalisht jamë pjesë e komsionit dhe kam kerku ndihm në shumë organizata dhe në Ministri të Financave pasi që më të vërtet jemi Komunë intereante, ne që jemi më larg qendres së Komunës paguajm më shumë arsyetimi është çmimi i tokës, të pakten të mundohemi unë kam kerku shumë ndihmi edhe prej Ministrisë së Financave dhe më kanë thënë se është duke u punuar në një plan strategjik dhe mos u mundoni ju se ndryshimet vin prej Ministrisë, dmth vullnetin e kemi por mundësi nuk po na dhëjnë, andaj është mirë me perkrah sot këtë qytetarë dhe po kerkoj nga ju me perkrah ose me ja pagu tatimin ose me ja zvoglu shumë e tatimit sa ka vlersuar komisioni që janë bërë dëmet.

Ramush Mehmeti tha: ai komision nese ka vlersuar pronën mundet me ardh në Kuvend dhe më thënë se kemi mundësi mi ndihmu për dëmet që janë bërë propozojm që këtë vlerë ta lirojmë prej tatimit në pronë.

Procesverbali i Kuvendit

Xhejlane Behluli tha: atëher në mbledhje të muajit shkurt do të interesohem se kush ka qenë në komision dhe sa e ka vlerësuar dëmin dhe do ta propozoj në KPF në mënyr të rregullt e pastaj do ta biem edhe në Kuvend dhe vendosni ju.

Dobriroje Djordjevic tha: një sqarim për znj. Xhejlane vendimi për atë rrugë është i nënshkruar nga Kryetari i cili e ka nënshkruar në protest me qytetarët, këto janë vet premtime të Kryetarit për këtë arsye kerkoj të di se ku ka ngec kjo punë.

Xhejlane Behluli tha: nuk fola vetem për atë rrugë por në përgjethësi për të gjitha kërkesat që i keni pas ju si komunitet dhe pasi që nuk po varka nga ne është Ministria e Infrastruktues drejtohuni atje.

Abdyl Gashi tha: po nderlidhem të propozimi i Xhejlanes ku mendoj se është propozim i mirë por para se gjithash duhet vepruar përmes proceduarve zyrtare, mendoj se ky është maltretim mi marrë qytetarët e tju thuani se shiheni se si ju përkrahi është e pandarshme, ne si asamblesita secilin qytetarë e përkrahim.


Xhejlane Behluli tha: unë veq sa i takova këtu i ke përkrahës të partis tënde dhe mundë të komunikosh me ta ose unë hiq spo e marr por mere persiper ti këtë qështje, është me rëndesi mos me u dëmtu qytetari.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic

Kryesues i Kuvendit



05-92
13.02.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



RAPORTI FINANCIAR

TË HYRAT DHE TË DALAT PËR PERIUDHEN

TETOR - DHJETOR 2019

SHKURT 2020

MUJTE E SHPENZUARA
Simbas shfrytezuesve te njesis buxhetore

Nr.	Shfrytezuesit e buxhetit	Paga dhe medijte					Shpenzime komunale	Subvencije	Invest kap
		Planifikuara	Shpenzuara	Mall dhe sherb	Shpenzuara	Shpenzuara			
1	Zyria e Kryetarit	17,375.25 €	17,509.92 €	32,501.73 €					
2	Administrata	41,800.00 €	40,629.94 €	15,956.12 €		89.35 €			
3	Zyria per Komunikim	1,300.00 €	413.39 €					4,760.00 €	
4	Zyria e barz. Gjimore	1,800.00 €	1,795.89 €						
5	Zyria e Kuvendit Komunal	17,500.00 €	18,611.91 €	2,119.40 €					
6	Buxhet dhe Financa	11,575.00 €	11,723.19 €	2,105.72 €					
7	Inspeksioni	7,043.00 €	7,082.28 €						
8	Sherbime Publike	18,349.00 €	17,546.65 €	6,945.96 €					
9	Zyria per Komunitete	7,726.00 €	7,925.01 €						61,579.00 €
10	Bujesi, Pylltari dhe ZHR	11,025.00 €	11,070.87 €						
11	Zhvillim Ekonomik	7,050.00 €	6,774.81 €					529.96 €	52,780.00 €
12	Planifikim dhe Rregulim Hapsinor	12,607.00 €	12,533.13 €						248,022.15 €
13	Sherbimi Primar Shendetesor	59,788.00 €	58,811.74 €	7,517.73 €					
14	Sherbime sociale	5,995.00 €	6,031.23 €			2,359.00 €			2,420.55 €
15	Kultur Rini dhe Sport	10,162.00 €	10,224.03 €			5,000.00 €			
16	Administrata Arsimit	10,875.00 €	11,015.46 €			4,017.00 €			
17	Arsimi I Mesem	48,125.00 €	48,621.53 €	7,594.04 €					5,000.00 €
18	Arsimi Fillor	182,648.00 €	182,957.49 €	20,476.13 €					
19	Arsimi parashkollor dhe qerdhe	3,125.00 €	3,140.40 €						1,466.00 €
Gjithsej		475,868.25 €	474,418.87 €	95,216.83 €	11,465.35 €	5,289.96 €	371,267.70 €		

Shpenzimet per tremujorin e tret 2019 . Per paga dhe medijte kane gene te planifikuara 475,868.25 €
ndersa jane shpenzuar 474,418.87 € ne perqindje 99.69 %.

Per maltra dhe sherbime ajne shpenzuar 95,216.83 €.
Per shpenzime Komunale jane shpenzuar 11,465.35 €.
Per subvencione jane shpenzuar 5,289.96 €.
Per investime kapitale jane shpenzuar 371,267.70 €.

Tabela për periudhen kohore Tetor-Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe Medite	Muaji	Plata	Mallra dhe sherbime	Shuma	Subvencione Sub. ent. ne jav.	Shuma	Totali
1	Paga	Telor	5,836.64 €	Shpenzimet e internetit	360.00 €			
2	Paga	Nentor	5,836.64 €	Shpenz. Tel. mob	2,400.00 €		4,760.00 €	
3	Paga	Dhjetor	5,836.64 €	Shpenz tjera kontraktues	347.00 €			
				Furnizim me kafe	1,321.48 €			
				Ushqim dhe pije	512.73 €			
				Dru	11,863.80 €			
				Derivate	1,607.81 €			
				Shpenzimet e Kryetarit	484.03 €			
				Sigurimi i mat.higjenik	1,500.00 €			
				Medijet per kontet	320.00 €			
				Servisin i automjeteit	985.00 €			
				Permbartuesi privat	9,176.18 €			
				Shpenzimet e transport	623.70 €			
				Shpenz. e mj. medicinale	1,000.00 €			
Gjithsej			17,509.92 €		32,501.73 €		4,760.00 €	54,771.65 €

Per paga dhe medije kane gene te planifikuara **17,375.25 €** ndersa jane shpenzuar **17,509.92 €** ne perqindje **100.78 %**.
Per malira dhe sherbime jane shpenzuar mjetet ne shume prej **32,501.73 €**.
Per subvencione jane shpenzuar mjetet ne shume prej **4,760.00 €**.

Per mailra dhe sherbime jane shpenzuar mjetet ne shume prej 32,501.73 €

Per subvencione jane shpenzuar mjetet ne shume prej **4,760.00 €**.

Tabela për periudhën kohore Tetor-Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Mallra dhe shërbime	Shuma	Shpenzime Komunale	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	13,887.80 €	Shpenzimet e udhëzimit	145.60 €	Shpenzimet e energjisë	89.35 €	
2	Paga	Nëntor	13,389.97 €	Shpenzimet e t. mob.	2,200.00 €			
3	Paga	Dhjetor	13,352.17 €	Shpenzimet tjera të kont.	4,096.69 €			
				Materiale dhe zyrtare	1,650.04 €			
				Ushqim dhe pijë	300.00 €			
				Derivate	4,228.47 €			
				Regjistrimi i automjeteve	310.00 €			
				Servisimi i automjeteve	281.00 €			
				Gazeta zyrtare	42.00 €			
				Pregaditja e projekteve	365.44 €			
				Paga	1,400.00 €			
				Sigurimi i automjeteve	936.88 €			
	Gjithsej		40,629.94 €		15,956.12 €		89.35 €	56,675.41 €

Per paga dhe medije kanë qene te planifikuara 41,800.00 €, ndersa jane shpenzuar 40,629.94 € ne perqindje 97.20 %

Per mallra dhe sherbime jane shpenzuar 15,956.12 €

Per shpenzime Komunale jane shpenzuar 89.35 €.

ZYRJA E KOMUNIKIMIT 16490

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Maltra dhe Sherbime	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	413.39 €			
2	Paga	Nentor	-			
3	Paga	Dhjetor	-			
	Gjithsej		413.39 €			

Per paga dhe medijtë kanë qene te planifikuara 1,300.00 € ndersa janë shpenzuar 413.39 € ne perqindje 31.80 %

ZYRJA PER BARZAI GJINORE 16530

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Maltra dhe sherbime	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	598.63 €			
2	Paga	Nentor	598.63 €			
3	Paga	Dhjetor	598.63 €			
	Gjithsej		1,795.89 €			

Per paga dhe medijtë kanë qene te planifikuara 1,800.00 € ndersa janë shpenzuar 1,795.89 € ne perqindje 99.77 %.

ZYRJA E KUVENDIT KOMUNAL 16930

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Maltra dhe sherbime	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	6,177.72 €	Shpenzimet e Kryesues	255.36 €	
2	Paga	Nentor	6,125.22 €	Furnizim per zyre	432.54 €	
3	Paga	Dhjetor	6,308.97 €	Punet tjera te kontraktit	370.00 €	
				Shpenzimet e tel	570.00 €	
				Ushqim dhe pije	491.50 €	
	Gjithsej		18,611.91 €		2,119.40 €	

Per paga dhe medijtë kanë qene te planifikuara 17,500.00 € ndersa janë shpenzuar 18,611.91 € ne perqindje 106.35 %.

Per maltra dhe sherbime janë shpenzuar 2,119.40 €.

BUXHET DHE FINANCA 17530

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Mallra dhe shërbime	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	3,907.73 €	Furnizim per zyre	1,441.42 €	
2	Paga	Nentor	3,907.73 €	Shpen. Tjet te kontr.	40.00 €	
3	Paga	Dhjetor	3,907.73 €	Dreka	108.90 €	
				Material Higjenik	42.40 €	
				Ushqim dhe pije	473.00 €	
	Ukupno		11,723.19 €		2,105.72 €	

Per paga dhe medijtë kane gene te planifikuara 11,575.00 € ndersa jane shpenzuar 11,723.19 € ne pergjindje 101.28 %.

Per mallra dhe shërbime jane shpenzuar 2,105.72 €

INSPEKSIONI 16659

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Mallra dhe shërbime	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	2,360.76 €			
2	Paga	Nentor	2,360.76 €			
3	Paga	Dhjetor	2,360.76 €			
	Ukupno		7,082.28 €			

Per paga dhe medijtë kane gene te planifikuara 7,043.00 € ndersa jan shpenzuar 7,082.28 € ne pergjindje 100.50 %.

SHERBIME PUBLIKE 18190

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Mallra dhe shërbime	Shuma	Investime kapitale	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	6,129.55 €	Material per zyre	392.20 €	Ndertimi I mugeve lokal	51,000.00 €	
2	Paga	Nentor	5,708.55 €	Paga	200.00 €	Trotuari	10,579.00 €	
3	Paga	Dhjetor	5,708.55 €	Shp. Tjet te kontr.	3,976.70 €			
				Kontrolla teknike	90.00 €			
				Materiali Higjenik	856.10 €			
				Ushqim dhe pije	561.50 €			
				Dreka	869.46 €			
	Gjithsej		17,546.65 €		6,945.96 €		61,579.00 €	86,071.61 €

Per paga dhe medijtë kane gene te planifikuara 18,349.00 € ndersa jane shpenzuar 17,546.65 € ne pergjindje 95.63 %.

Per mallra dhe shërbime jane shpenzuar 6,945.96 €.

Per investime kapitale jane shpenzuar 61,579.00 €.

ZYRJA E KOMUNITETEVE 19650

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Mallra dhe sherbime	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	2,641.67 €			
2	Paga	Nentor	2,641.67 €			
3	Paga	Dhjetor	2,641.67 €			
Ukupno			7,925.01 €			

Per paga dhe medijtë kane qene te planifikuara 7,726.00 € ndersa jane shpenzuar 7,925.01 € ne perqindje 102.57 %.

BUQËSI, PYLLTRI DHE ZHVILLIM RURAL 47030

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Subvencione	Shuma	Investime Kapitale	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	3,690.29 €	Subven. Za nejavne	529.96 €	Stigurnimi i mjeteve bujqes	52,780.00 €	
2	Paga	Nentor	3,690.29 €					
3	Paga	Dhjetor	3,690.29 €					
Gjithsej			11,070.87 €		529.96 €		52,780.00 €	64,380.83 €

Per paga dhe medijtë kane qene te planifikuara 11,025.00 € ndersa jane shpenzuar 11,070.87 € ne perqindje 100.42 %

Per subvencione jane shpenzuar 529.96 €.

Per investime kapitale jane shpenzuar 52,780.00 €.

ZHVILLIM EKONOMIK 48030

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Subvencione	Shuma	Investime Kapitale	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	2,258.27 €			Ndertimi i rrug. Lokal	179,732.22 €	
2	Paga	Nentor	2,258.27 €			Trotuar	6,729.19 €	
3	Paga	Dhjetor	2,258.27 €			Kanalizim	19,049.00 €	
						Mirembajtja e nderqinit	29,931.74 €	
						Mjetet tjera	12,580.00 €	
Gjithsej			6,774.81 €				248,022.15 €	254,796.96 €

Per paga dhe medijtë jane planifikuar 7,050.00 € ndersa jane shpenzuar 6,774.81 € ne perqindje 96.09 %.

Per investime kapitale jane shpenzuar 248,022.15 €.

Tabela për periudhën kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Malira dhe sherbime	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	4,177.71 €			
2	Paga	Nëntor	4,177.71 €			
3	Paga	Dhjetor	4,177.71 €			
Gjithsej			12,533.13 €			

Per paga dhe medijtë janë planifikuar 12,607.00 € ndërsa janë shpenzuar 12,533.13 € në përqindje 99.40 %.

SHERBIMI PRIMAR SHENDETSOR 74800

Tabela për periudhën kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Malira dhe sherbime	Shuma	Shpenzime Komunalet	Shuma	Invest. Kapitale	Shuma
1	Paga	Tetor	19,643.50 €	Paga	1,400.00 €	Energjia elektrike	2,359.00 €		
2	Paga	Nëntor	19,643.50 €	Furnizim për zyrë	462.10 €				
3	Paga	Dhjetor	19,524.74 €	Punet tjerë të kontraktit	813.00 €				
				Shpenzime tel.	785.00 €				
				Servisim i automjeteve	301.00 €				
				Dreka	462.10 €				
				Dervate	2,559.53 €				
				Mjete medicinale	735.00 €				
Gjithsej			58,811.74 €		7,517.73 €		2,359.00 €		2,420.55 €

Per paga dhe medijtë kanë qenë të planifikuara 59,788.00 € ndërsa janë shpenzuar 58,811.74 € në përqindje 98.36 %.

Per shpenzime Komunalet janë shpenzuar 2,359.00 €.

Per malira dhe sherbime janë shpenzuar 7,517.73 €

Per investime kapitale janë shpenzuar 2,420.55 €.

SHERBIME SOCIALE 75646

Tabela për periudhën kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Malira dhe sherbime	Shuma	Shpenzime Komunalet	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	2,010.41 €			Mbeturnat	1,950.00 €	
2	Paga	Nëntor	2,010.41 €			Energjia Elektrike	3,050.00 €	
3	Paga	Dhjetor	2,010.41 €					
Gjithsej			6,031.23 €				5,000.00 €	

Per paga dhe medijtë janë planifikuar 5,995.00 € ndërsa janë shpenzuar 6,031.23 € në përqindje 100.60 %.

Per shpenzime Komunalet janë shpenzuar 5,000.00 €.

KULTUR RINI DHE SPORT 85030

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Mallra dhe sherbime	Shuma	Shpenzime Komunalet	Shuma
1	Paga	Tetor	3,408.01 €			Energjia Elektrike	4,017.00 €
2	Paga	Nentor	3,408.01 €				
3	Paga	Dhjetor	3,408.01 €				
Gjithsej			10,224.03 €				4,017.00 €

Per paga dhe medijtë kane qene te planifikuar 10,162.00 € ndersa jane shpenzuar 10,224.03 € ne pergjindje 100.60%.

Per shpenzime Komunalet jane shpenzuar 4,017.00 Evra.

ADMINISTRATA ARSIM 92150

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Mallra dhe sherbime	Shuma	Investime Kapitale	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	3,671.82 €					
2	Paga	Nentor	3,671.82 €			Krecenje skola	5,000.00 €	
3	Paga	Dhjetor	3,671.82 €					
Ukupno			11,015.46 €				5,000.00 €	

Per paga dhe medijtë jane planifikuar 10,875.00 € ndersa jane shpenzuar 11,015.46 € ne pergjindje 101.29 %.

Per investime Kapitale jane shpenzuar 5,000.00 €.

ARSIMI MESEM 95070

Tabela për periudhen kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Mallra dhe sherbime	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	15,911.73 €	Furnizim per zyre	2,584.90 €	
2	Paga	Nentor	16,315.12 €	Shpenzime. Tjer te kontr	2,137.00 €	
3	Paga	Dhjetor	16,394.68 €	Permbartesi	408.04 €	
				Paga	200.00 €	
				Ushqim dhe Pije	237.00 €	
				Transport	1,977.10 €	
				Dreka	50.00 €	
Gjithsej			48,621.53 €		7,594.04 €	50,926.89 €

Per paga dhe medijtë jane planifikuar 48,125.00 € ndersa jane shpenzuar 48,621.53 € ne pergjindje 101.03 %.

Per mallra dhe sherbime jane shpenzuar 7,594.04 €

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Mallra dhe shërbime	Shuma	Investime Kapitale	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Tetor	61,306.49 €	Furnizim per zyre	689.50 €	Mjete te IT	1,466.00 €	
2	Paga	Nentor	60,765.82 €	Furnizim me laptop	475.00 €			
3	Paga	Dhjetor	60,885.18 €	Punet tjera kontrakt.	5,807.30 €			
				Ushqim dhe pije	608.65 €			
				Material Higjenik	99.90 €			
				Paga	1,400.00 €			
				Dreka	271.72 €			
				Peti kes	2,000.00 €			
				Marketing	250.00 €			
				Servisim i automjeteve	980.00 €			
				Shpenzime te medjeteve	78.00 €			
				Shpenzim i trajnim	3,424.40 €			
				Aparat i fotokopies	1,135.00 €			
				Publikimi i gazetave	863.40 €			
				Mjete per teknologjin in	898.00 €			
				Transporti i nxevesve	1,495.26 €			
	Gjithsej		182,957.49 €		20,476.13 €		1,466.00 €	204,899.62 €

Per paga dhe medijtë kane qene te planifikuara 182,648.00 € ndersa jane shpenzuar 182,957.49 € ne perqindje 100.16 %.

Per mallra dhe shërbime jane shpenzuar 20,476.13 €

Per investime kapitale jane shpenzuar 1,466.00 €.

ARSIMI PARASHKOLLOR DHE QERDHET

Tabela për periudhën kohore Tetor- Dhjetor 2019

Nr.	Paga dhe medijtë	Muaji	Paga	Mallra dhe shërbime	Shuma
1	Paga	Tetor	1,046.80 €		
2	Paga	Nentor	1,046.80 €		
3	Paga	Dhjetor	1,046.80 €		
	Gjithsej		3,140.40 €		

Per paga dhe medijtë jane planifikuar 3,125.00 € ndersa jane shpenzuar 3,140.40 € ne perqindje 100.40 %.

9. Srdjan Todorović
Drejtör per buxhet dhe Financa

vula:

9. Svetislav Ivanović
Kryetar i Komunes

vula: